



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2022:050173

Datë: 03.10.2024

Numri i dokumentit: 06248408

K.DH.Sh. II.nr.1519/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtaren Franciska Zhitija Ymeri në çështjen përmbartimore të kreditorit Raiffeisen Bank Kosovë Sh.A., me seli në Prishtinë, rr. “Robert Doll”, nr. 99, kundër debitorëve; 1. “EL-FA” Sh.P.K., me numër të biznesit 70307469 dhe seli në Prishtinë, rr. “Mujë Krasniqi”; 2. E.M. me numër personal ... dhe adresë në Prishtinë, si dhe; A.M. me numër personal ... dhe adresë në Prishtinë, të cilët i përfaqëson sipas autorizimit Fatbardh Makolli, avokat nga Prishtina, me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorëve të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1704/22, të datës 18.10.2023, me datë 03.10.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET si e bazuar ankesa e debitorëve 1. “EL-FA” Sh.P.K., me numër të biznesit 70307469 dhe seli në Prishtinë, rr. “Mujë Krasniqi”; 2. E.M. me numër personal ... dhe adresë në Prishtinë, si dhe; A.M., ANULOHET aktvendimi i Gjykata Komerciale – Dhomat e shkallës së Parë, KPPP.nr.1704/22, të datës 18.10.2023 dhe lënda kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin KPPP.nr.1704/22, të datës 18.10.2023, ne dispozitiv të aktvendimit

ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorëve “EL-FA” Sh.P.K., me seli në Prishtinë; E.M. nga Prishtina, si dhe A.M. nga Prishtina, ushtruar ndaj Urdhrit Përmbarrimor P.nr. 59/22, të lejuar me datë 14.02.2022, nga Përmbarruesi Privat Saranda Rexhepi.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor kanë ushtruar ankesë debitorët nëpërmjet përfaqësuesit të tyre të autorizuar, për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale si dhe për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjës faktike, duke kërkuar nga gjykata e shkallës së dytë të anulohet vendimin e Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1704/22, të datës 18.10.2023, dhe lënda të kthehet në rivendosje në gjykatës e shkallës së parë.

Kreditori ka ushtruar përgjigje në ankesë nëpërmjet së cilës ka kërkuar nga gjykata e shkallës së dytë që ankesën e debitorëve ta refuzoj si të pabazuar, ndërsa aktvendimin e Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1704/22, të datës 18.10.2023, ta vërtetoj.

Ankesa e debitorëve është e themeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Raiffeisen Bank Kosovë (RBKO), me seli në Prishtinë, ka lëshuar Urdhrin përmbarrimor P.nr. 59/22, të lejuar me datë 14.02.2022, me të cilin ka lejuar përmbarrimin mbi bazën e dokumentit përmbarrimor, Marrëveshjes mbi pengun e datës 24.04.2019, për sigurimin e kërkesave nga Kontrata mbi kredinë nr. 200719633 e datës 24.04.2019, e regjistruar në regjistrin e pengut sipas Konfirmimit mbi regjistrim R-20190426-286, si dhe Marrëveshjes mbi pengun e datës 25.08.2020, për sigurimin e kërkesave nga Kontrata mbi linjën e kredisë nr. 200726180 e datës 25.08.2020, e regjistruar në regjistrin e pengut sipas Konfirmimit mbi regjistrimit e pengut me R-20200828-310, ka lejuar Urdhrin Përmbarrimor P.nr. 59/22, të datës 14.02.2022, ndaj debitorëve për pagesën e detyrimit në shumë të përgjithshme prej EUR 42,285.22, me kamatë të rregullt dhe kamatëvonesë deri në përmbushje definitive, përmes bllokimit të llogarive bankare të debitorëve dhe bartjen e mjeteve nga llogaritë e debitorëve në atë të kreditorit, ose përmes sekuestrimit të kolateralit të lënë peng dhe shitjen e tij me qëllim të realizimit të kërkesës.

Përmbauesi Privat Saranda Rexhepi me seli në Prishtinë, duke vepruar sipas propozimit për përmbauesim të kreditorit me urdhrin përmbauesimor P.nr. 59/22, të lejuar me datë 14.02.2022, e ka lejuar përmbauesimin e propozuar nga kreditorit, ndërsa debitorët brenda afatit ligjor kanë ushtruar prapësimit me të cilin kanë kundërshtuar në tërësi urdhrin mbi lejimin e përmbauesimit, me arsyetim se dokumenti mbi bazën e së cilit është lejuar urdhri nuk përbën dokument të ekzekutueshëm në kuptim të dispozitave të LPP-së, ngase nuk është aktgjykim i plotfuqishëm, ujdi gjyqësore dhe as dokument administrativ. Me tej, ka theksuar se dokumenti në fjalë nuk përmban formën e një dokumenti të ekzekutueshëm ngase nuk sqarohet statusi apo fare nuk tregohet obligimi i debitorëve dhe mënyrë se si është krijuar ky obligimi, dhe nëse i njëjti është i ligjshëm. Ka shtuar se borxhi të cilin kreditorit kërkon ta realizoj është përfshi në parashkrim në kuptim të nenit 360 të LMD-së, ndërsa ka theksuar se organi përmbaues ka aplikuar gabimisht edhe Ligjin për pronësi dhe të drejtat tjera sendore ngase kjo çështje bie në kompetencë të gjykatës dhe jo përmbauesit privat. Në fund, ka theksuar se dokumenti mbi të cilin është lejuar urdhri nuk përmban elementet e dokumentit përmbauesimor. Për këto arsye, gjykatës i ka propozuar që prapësimitin e debitorëve ta aprovoj si të bazuar, ashtu që urdhri mbi lejimin e përmbauesimit të anulohet.

Kreditorit, në përgjigje në prapësimitin ka theksuar se debitorët nuk kanë paraqitur prova për të mbështetur pretendimet e tyre të paraqitura në prapësimitin në kuptim të nenit 69.4 të LPP-së. Ka theksuar se procedura përmbauesimore është iniciuar mbi bazën e marrëveshjes së pengut e cila në kuptim të nenit 22, pika 1.7a të LPP-së, përbën dokument përmbauesimor. Me tej, ka shtuar se debitorët janë në vonesë të kthimi të obligimeve ndaj kreditorit, ndërsa tendenca e debitorëve është zvarritja e procedurës, andaj gjykatës i ka propozuar që prapësimitin e debitorëve ta refuzoj si të pabazuar dhe urdhri përmbauesimor të mbetet në fuqi.

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, pas vlerësimit të prapësimitit, përgjigjes në prapësimitin dhe shkresave në lëndë, ka nxjerrë aktvendimin KPPP.nr.1704/22, të datës 18.10.2023, me të cilin ka refuzuar si të pabazuar prapësimitin e debitorëve “EL-FA” Sh.P.K., me seli në Prishtinë; E.M. nga Prishtina, si dhe A.M. nga Prishtina, ushtruar ndaj Urdhrit Përmbauesimor P.nr. 59/22, të lejuar me datë 14.02.2022, nga Përmbauesi Privat Saranda Rexhepi.

Në arsyetim të aktvendimit të ankimuar gjykata ka vlerësuar se dokumentet përmbarese përbëjnë bazë juridike për caktimin e përmbarimit, ngase i kanë plotësuar kushtet ligjore nga neni 27 i LPP-së, për të qenë të përmbarueshme dhe njëkohësisht të përshtatshëm për përmbarim. Duke shtuar se Marrëveshja e Pengut të datës 24.04.2019 për sigurimin e kërkesave nga Kontrata e Kredisë nr.200719633 dhe Marrëveshjes së Pengut të datës 25.08.2020 për sigurimin e kërkesave nga Kontrata e Kredisë nr.200719633 dhe Marrëveshjes së Pengut të datës 25.08.2020 për sigurimin e kërkesave nga kontrata mbi linjën e kredisë nr.200726180 e datës 25.08.2020 gjeti se të njejtat janë të regjistruara në regjistrin zyrtar të pengut sipas konfirmimit për regjistrimin e pengut me R-20190426-286 e datës 26.04.2019 dhe R-20200828-310 e datës 28.08.2020, dhe se janë paraqitur në origjinal dhe si të tilla përbëjnë bazën juridike për caktimin e përmbarimit, ngase i plotësojnë kushtet ligjore nga neni 22 pika 1.7a dhe neni 27 të LPP-së, për të qenë të përmbarueshme dhe njëkohësisht të përshtatshme për përmbarim. Po ashtu ka cek se gjykata ka vlerësuar pretendimet e debitorit lidhur me parashkrimin por i refuzoi si të pa bazuar për shkak se nuk kanë kaluar 3 vite nga momenti kur detyrimi i debitorëve është bërë i arritshëm për pagesë e deri në datën e paraqitjes së propozimit për përmbarim nga ana e kreditorit pranë organit përmbareues ashtu sipas nenit 355.1 të LMD-së.

Gjykata e Komerciale -Dhoma e Shkalles e Dytë, qëndrimin dhe përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë nuk mund ta përkrah si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (n) e LPK-së, sepse arsyet e paraqitura lidhur me faktet vendimtare të çështjes janë të paqarta. Gjendja faktike rezulton të mos jetë vërtetuar plotësisht dhe në mënyrë të drejtë me çka ka ardhur edhe deri te aplikimi i gabuar i të drejtës materiale po ashtu aktvendimi i atakuar është përfshirë në vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike nga neni 183 të LPK-së.

Gjykata e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë me rastin e vendosjes ka qenë e obliguar që të vlerësojë nëse janë përmbushur prezumimet lidhur me përmbajtjen e dokumenteve përmbarese që duhet ti bashkëngjiten propozimit për përmbarim, kështu gjykata e shkallës së parë nuk i ka vlerësuar se në rastin konkret dokumentet në bazë të cilave është caktuar përmbarimi a i plotësojnë kushtet e parapara me dispozita ligjore për të qenë dokumente të përmbarueshme, pasi që gjykata e shkallës së parë ka cek vetëm konfirmimin për regjistrimin e pengut me R-

20190426-286 e datës 26.04.2019 se është në origjinal por nuk ka vlersuar se dokumente tjera përmbarues a janë në origjinale ose kopje të vërtetuara, siç parashihet me dispozitat ligjore. Neni 36 par.1 të LPP përcakton se *“Se bashku me propozimin për përmbarim, organi përmbarues i dorëzohet edhe dokumenti përmbarues, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbarueshmërisë për përmbarueshmëri”*. Po ashtu edhe sipas neni 38 par.1 të LPP-së, parasheh që propozimi për përmbarim duhet ta përmbajë: *“kërkesën për përmbarim në të cilën do të tregohet dokumenti përmbarimor origjinal apo kopje e vërtetuar....”* ndërsa me paragrafin 2 parasheh se: *“Në rast se propozimi për përmbarim nga paragrafi 1. i këtij neni nuk përmban shënimet e kërkuara, organi përmbarues do të veprojë sipas dispozitave të nenit 102 të Ligjit të Procedurës Kontestimore, i cili nen në paragrafin 1 përcakton, se: “Kur një parashtrësë nuk arrin të jetë e kuptueshme dhe e plotë, siç kërkohet në paragrafin 2 të nenit 99, gjykata do ta thërrasë personin që e dërgon ta korrigjojë ose ta plotësojë parashtrësën. Në një rrethanë të tillë, gjykata e udhëzon palën për korrigjimet dhe për plotësimet që do të zënë vend dhe e cakton një periudhë treditore për korrigjimin dhe për plotësimin e parashtrësës”*. Andaj në rastin konkret gjykata e shkallës së parë ka anashkaluar këtë fakt me rastin e vendosjes, për çka gjykata e shkallës dytë, vlerëson se aktvendimi i shkallës së parë është i paqëndrueshëm dhe si i tillë duhet të anulohet dhe çështja të kthehet në shkallë të parë në rishqyrtim.

Gjykata e shkallës së parë udhëzohet që në ri procedurë të bëjë eliminimin e shkeljeve konform të gjeturave nga gjykata e shkallës së dytë, ashtu që të konfirmoj se dokumentet mbi bazën e të cilave është caktuar përmbarimi a i plotësojnë kushtet për te qenë dokumente të përmbarueshme, të analizoj pretendimet të palëve në procedurë, të konstatoj saktë gjendjen e fakteve me prova konkrete, e më pastaj duke vlerësuar edhe shkaqet ligjore nga neni 71 të LPP-së, të vendos sipas dispozitave ligjore.

Nga të cekurat me lartë, e në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 195, 208 dhe 209 par. 1 pika (d) e LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Numri i lëndës: 2022:050173
Datë: 03.10.2024
Numri i dokumentit: 06248408

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-DHOMA E SHKALLËS SË DYTË

K.DH.SH.II nr.1519/23, me datë 03.10.2024

Gjyqtarja,
Franciska Zhitija Ymeri